



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	-29621/25
Nr. i fq. / Br. st.	
Data: / Datum:	30.06.2025
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri

**Procesverbali nga takimi i parë publik me qytetarë i Kryetarit të Komunës për punën
gjashtë mujore Janar - Qershor 2025**

Qershor, 2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i parë publik me qytetarë i kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për punën gjashtë mujore Janar - Qershor 2025.

Datë: 30.06.2025

Ora: 11:00

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Takimi është hapur nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, i cili para qytetarëve të pranishëm ka prezantuar raportin për punën gjashtë mujore (Janar - Qershor 2025) të ekzekutivit.

Të pranishëm kanë qenë edhe të gjithë drejtorët e drejtorive.

Ferit Idrizi, kryetar i Komunës së Vushtrrisë, falënderoi qytetarët pjesëmarrës në takim.

Fillimisht para juve do të paraqes një përmbledhje të punëve që janë bërë nga janari deri në muajin qershor 2025, e më pas do të keni edhe ju mundësinë që të bëni pyetje.

Sa i përket arsimit kemi ofruar mbështetje me 70 bursa për universitetet publike dhe private, ku shuma e bursës ka qenë 600 euro, janë dhënë 15 bursa për studentët që studiojnë në vendet e regjionit si Shqipëri, Maqedoni në vlerë 800 euro, si dhe janë dhënë bursa për studentët që studiojnë në vendet e BE-së në vlerë 1000 euro.

Gjithashtu Komuna e Vushtrrisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me City College, kampusin Universitar të York University që është në Selanik, ku janë dhënë 10 bursa për studentët që studiojnë në fushat deficitare si programim, Inteligjenca Artificiale dhe Psikologjia Klinike.

I kemi subvencionuar të rinjtë dhe të rejat që i ndjekin trajnimet në fushën e zhvillimit softuerik në Speex Education, të gjithë të rinjtë dhe të rejat e Vushtrrisë e kanë mundësinë që në 5 profilet e programimit t'i ndjekin këto trajnime për gjashtë muaj në Speex dhe kjo vlerësoj që ka qenë një arritje shumë e madhe.

Gjithashtu janë subvencionuar ata që kanë ndjekur kurset e gjuhës gjermane dhe frënge në Speex Education.

Në vitin 2023 nga këto subvencionime kanë përfituar 1219 persona, vlera e subvencioneve ka arritur në 127 mijë e 60 euro. Në vitin 2024 kanë përfituar 390 persona, vlera ka qenë 55,635.00 euro. Në vitin 2025 kanë përfituar 647 persona në vlerë 85,190.00 euro.

Po ashtu, arsimit për të rritur, të rinjtë e papunë i kemi subvencionuar duke ju ofruar trajnime profesionale në arsimin profesional, në qendrat e akredituar, më së shumti nga ta kanë shkuar në qendrën gjermane Diakonie Center. Në vitin 2023 kanë përfituar 37 veta në vlerë 9,100.00 euro, në vitin 2024 kanë përfituar 8 persona vlera e të cilëve ka qenë 1,440.00 euro, në vitin 2025 kanë përfituar 22 persona, vlera 5,260.00 euro.

Kur jemi te fusha e arsimit, dua të ju njoftoj që është në përfundim e sipër ndërtimi i shkollës moderne në oborrin e shkollës fillore "Mustafë Venhari" dhe janë duke u riadotuar edhe dy

çerdhe, njëra është në Shtitaricë aty ku dikur ka qenë shtëpia e kulturës dhe tjetra në Stanocin e Epërm aty ku ka qenë shkolla fillore "Migjeni".

Shkolla e Mesme e Ulët 2, është pajisur me kabinete moderne të kimisë, fizikës dhe biologjisë, gjithashtu Qendra për Arsimin dhe Edukimin e të Rinjve dhe të Rejave në Vushtri është hapur.

Po ashtu, të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në gara nacionale dhe ndërkombëtare, komuna ju ka mbuluar udhëtimin atyre, qoftë bileta me aeroplan për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Unë i falënderoj të gjithë mësime të cilët kanë bashkëpunuar që t'i përgatisin këta nxënës për këto gara, e që jemi shumë krenar. Në vitin 2023, janë mbështetur 38 nxënës me shumë 3,420 euro. Në vitin 2024, janë mbështetur 39 nxënës në vlerë 15,700 euro. Në vitin 2025, janë mbështetur 28 nxënës në vlerë 12,500 euro.

Po ashtu, Komuna e Vushtrisë është komuna e parë që ka realizuar kuizin e diturisë, përmes programit të digjitalizuar. Patjetër që i kemi shpërblyer të gjithë mësime të cilët kanë qenë pjesë e këtyre garave.

Mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore ka vazhduar prej që e kemi marrë mandatin.

Urbanizëm:

Tash është bërë nënshkrimi i marrëveshjes me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal ku do të bëhet ura mbi lumin Silnica që do të ketë një pamje moderne.

Ka vazhduar ndërtimi i tregut të gjelbër, ku në muajin shtator pritet të bëhet finalizimi.

Kemi filluar ta ndërrojmë pamjen e pjesës para Shtëpisë së Kulturës, me parkun e ri.

E kemi ndërtuar edhe një park në Lumadh. Parku rekreativ te ura e gurit, janë duke vazhduar punimet.

Kemi mbjellë drunjtë dekorativ dhe do vazhdojmë të mbjellim që ta kthejmë gjelbërimin e qytetit.

Komuna e Vushtrisë ka filluar renovimin e banesave kolektive - nevojë jashtëzakonisht e madhe për renovimin e tyre. Fondi për këtë projekt është marrë nga fondi për subvencione sepse nuk kemi gjetur asnjë bashkëfinancues.

Shërbime Publike:

Kemi vazhduar me rikonstruimin e rrugëve nëpër qytet. Ideja ka qenë që t'i kryejmë të gjitha punët nëpër qytet pa ardhur mërgimtarët, në mënyrë që ta kenë më të lehtë qarkullimin, pa pengesa.

Asfaltimi i rrugëve për Skoqne në procedurë të tenderimit, edhe këtu kemi nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës.

E kemi asfaltuar rrugën e Dumnicës me gjatësi 10.5 km, rrugë kjo në bashkëfinancim. Kemi rrugën Akrashticë-Balincë edhe kjo rrugë është në finalizim.

Rruga "Drenica" e cila është në bashkëfinancim që fillon nga ura e Silnicës, e deri në drejtim të Skenderajt është në finalizim e sipër, edhe aty është bërë një zgjerim dhe kemi vendosur edhe trupat ndriçues që janë në finalizim e sipër.

Edhe te rrugët e kategorisë së katërt kemi intervenuar nëpër shumë fshatra dhe kemi shtruar shumë rrugë, duke u bazuar në kërkesat e bujqve.

Kemi lidhur një rrugë që kalon nëpër Pestovë dhe lidhet me fshatin Mavriq.

Rruga Pestovë - Druar gjithashtu është në finalizim.

Në rrugën e Dobërllukës kemi pasur një problem me urën e Silnicës e cila ka qenë thuajse e pakalueshme për shkak të demolimit, por para dy ditësh kemi filluar me rindërtimin.

Trotuar në Dobërllukë dhe Reznik e Stroc.

Jemi duke punuar gjithashtu edhe në furnizim me ujë të pijshëm për banorët në qytet dhe disa fshatra.

Këto vonesa në investime kapitale e kanë adresën te kontrata kolektive ku deri tashmë na u kanë marrë 9 milion euro.

Bujqësi:

Kemi vazhduar me subvencionimin e ujitjes së tokave. Kemi subvencionuar me 5 cent për litër qumësht. Subvencionim për kokë dhie, dele, buallice. Ndoshta i kemi vonuar pak këto subvencione për shkak të vonesave, por ta dinë bujqit që do t'i marrin së shpejti.

Kulture Rini dhe Sport:

I kemi subvencionuar Organizatat Jo Qeveritare, ku kanë përfituar 122 OJQ me 323,760.00 euro. Janë mbështetur 163 Aktivitetet kulturore në shumën 80,429.00 euro. Janë mbështetur 55 aktivitete shkencore në shumën 8,100.00 euro. Te aktivitetet shkencore për herë të parë në Komunën e Vushtrrisë janë mbajtur shumë tryeza dhe diskutime shkencore në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës. Janë mbështetur 14 persona për botimin e librave në shumën 14,700.00 euro. Edhe te botimi i librave, i kemi mbështetur të gjithë ata që kanë bërë kërkesa.

Gjithashtu artistët janë mbështetur për incizimin e këngëve. Nuk kemi hezituar asnjëherë t'i mbështesim artistët dhe sportistët.

Sport

Përpos mjeteve nga fondi për subvencione, kemi bërë ndërmjetësim tek bizneset për sponsorizim të klubeve sportive.

Administrata:

Qytetarët s'kanë pasur vërejtje për administratën. Krijimi i kushteve për zyrtarët e administratës ka qenë prioritet, pasi që zyrtarët e administratës nuk kanë pasur kushte pune.

Transparencë:

Rezultatet jashtëzakonisht të mira nga organizatat kredibile që bëjnë matjen e transparencës së Komunave, KDI e ka renditur Komunën e Vushtrrisë në mesin e komunave më transparente me 95.83% në vitin 2024.

Shëndetësi

Para një jave kemi bërë inaugurimi i mamografisë, që identifikon dhe zbulon kancerin e gjirit në fazat e hershme.

Mbrojtje dhe Shpëtim:

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim ka punuar jashtëzakonisht mirë në pastrimin dhe zgjerimin e lumenjve dhe prockave dhe prronjëve. Pastrimi i prockës në Lumadh, pastrimi i lumit Podranqa dhe do vazhdohet me pastrimin e lumit Tërstena.

Më pas fjala ka kaluar tek qytetarët, të cilët kanë paraqitur kërkesat e tyre.

Ismail Haziri, nga lagjja Urbane “Dardania”, analizat në QKMF në rrugën Dëshmorët e Kombit keni premtuar që së shpejti do t’i bini aty por nuk janë sjellë.

Qerim Januzi, nga fshati Pasomë, pikat e ndara nga kadastri dhe inspektorati nuk janë askund ku duhet rruga ka mbet ngushticë për shkak të mospërfilljes së pikave të kadastrit.

Halil Mulaku, nga Shoqata e Veteraneve të Arsimit, në emër të shoqatës falënderim për përkrahjen që kryetari i ofron kësaj shoqate.


Muharrem Imeri, nga fshati Dumnicë, lagjja Zena, te varrezat e dëshmorëve komesacioni te magjistranja, Ibër Lepenci nuk është funksional, që sa vite jemi pa të, e pa ujësjellës, infrastruktura ka mbet edhe një rrugicë 120 m. Nga magjistranja deri tek varrezat është premtuar rruga. A ka mundësi me i jep pamje varrezave?

Shaban Krasniqi, artist, Desha kryetarit të ja parashtroj një çështje është fjala për objektin përkatësisht shtëpinë e Xhezair Pasomës ku ka ndodhë masakra në Kosovë, kërkojmë që ajo shtëpi të shndërrohet në muze.

Takimi ka përfunduar në ora 12:30.

Procesmbajtëse:

Albiona Isa



Kryetari i Komunës së Vushtrrisë

Ferit Idrizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri



Lista e pjesëmarrësve

Takimi i parë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Datë: 30.06.2025

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	MUHARREM IMERI		Dumnic
2	Bashkim Rexha		Dubovc
3	Qerim Ismaili		PASONË
4	Ulora Mehmet		Yugslavi
5	Mustafa Halili		Vushtri
6	Bitoll Arifaj		Vushtri
7	Ismael Horizi		Vushtri
8	Murtez Dallku		Vushtri
9	Halil Mulla		Vushtri
10	RAIF LAHU		VUSHTRI
11	Agim Neka Hoxha		Vushtri
12	Medina Benjaku		Vushtri
13	Isuf Jashari		Vushtri
14	Fajon Mehmet		Abroshkë
15	Abdullë Hoxha		PESROKË



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Lista e pjesëmarrësve

Takimi i parë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Datë: 30.06.2025

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
16	ERGIN SUNGUR		VUSHTRRI
17	IZET MIFTARI		VUSHTRRI
18	BESIM DOKURRI		Vushtrri
19	Revan Hoxha		Vushtrri
20	Enver Bajrami		Vushtrri
21	Shaban Krasni		Vushtrri
22	FAZLI RASHICA		Vushtrri
23	SHKELZEN OSMANI		VUSHTRRI
24	Beqat Muxhori		Vushtrri
25	BASHKIM SAOITU		VUSHTRRI
26	Agron Mustafa		Vushtrri
27	Blerina Neri		Vushtrri
28	Revan Hoxha		
29	Hagbi		Vushtrri
30	ASTRIT		STANOC